

# EMIGRIMI KOMBËTAR I TË RINJËVE NË KOMUNËN E GJAKOVËS

---

DHJETOR 2018



**EMIGRIMI KOMBËTAR I TË  
RINJËVE NË KOMUNËN E  
GJAKOVËS**

---

DHJETOR 2018



## **PËRMBAJTJA**

Abstrakti.....	6
Hyrje.....	6
Rishikimi i Literaturës.....	7
Metodologjia.....	12
Të Gjeturat.....	12
Konkluzioni.....	19
Referencat.....	20

## **PJESËMARRËSIT**

Këtë vit akademik janë dorëzuar 23 aplikacione ndërsa 13 janë pranuar në listën përfundimtare të punimeve të përfshira në Revistën e Hulumtimeve të Studentëve. Nga 13 punimet hulumtuese, 12 janë përgatitur nga studentët e nivelit baçelor dhe 1 nga studentët e nivelit master. Më konkretisht, 5 punime hulumtuese janë përgatitur nga studentët e Departamentit Biznes dhe Menaxhment, 4 nga studentët e Departamentit të Shkencave Kompjuterike, 3 nga studentët e Departamentit të Gjuhës Angleze dhe 1 nga Departamenti i Shkencave Politike.

## **KOMISIONI VLERËSUES**

Komisioni vlerësues i hulumtimit përbëhet nga Drejtoresha e Operacioneve Biznesore e kolegjit Universum dhe Drejtori Akademik i institucionit. Ky komision ka qënë përgjegjës për hartimin e kriterëve dhe sigurimin e cilësisë së hulumtimit të bërë. Lista e anëtarëve të Komisionit Vlerësues është paraqitur më poshtë:

### **Arlinda Berisha**

Drejtoreshë e Operacioneve Biznesore

[arlinda@universum-ks.org](mailto:arlinda@universum-ks.org)

### **Uran Rraci**

Drejtor Akademik

[uran.rraci@universum-ks.org](mailto:uran.rraci@universum-ks.org)

## **EDITOR**

### **Rrezart Dema**

Asistent Ligjërues dhe i Hulumtimeve

[rrezartdema@universum-ks.org](mailto:rrezartdema@universum-ks.org)

## Emigrimi Kombëtar i të Rinjëve në Komunën e Gjakovës

### Abstrakti

Emigrimi kombëtar shfaqet si dukuri relativisht e zakonshme pothuajse në të gjitha shtetet në botë. Hulumtimi “Emigrimi Kombëtar i të Rinjëve në Komunën e Gjakovës” shqyrton perceptimin e të rinjëve në këtë komunë për komunën e tyre bazuar në disa indikatorë kyç si ekonomia, shëndetësia, arsimi, siguria dhe kultura e në të njëjtën kohë mat edhe dëshirën e tyre për një largim të mundshëm në një qytet tjetër në territorin e Kosovës. Ky hulumtim është realizuar nga studentët e Kolegjit Universum. Mostra e këtij hulumtimi kanë qenë 250 të rinjë nga pjesa rurale dhe urbane e Gjakovës të moshës prej 18 deri 35 vjeç. Dy janë të gjetura kryesore të këtij hulumtimi: Të rinjtë në Komunën e Gjakovës janë në masë të madhe pro idesë për të emigruar diku tjetër në Kosovë dhe arsye kryesore për emigrim janë mundësitë më të mira për punë.

### Hyrje

Fenomeni i emigrimit kombëtar paraqitet pothuajse në gjithë botën. Problemet e ndryshme sociale në një vendbanim të caktuar dhe nevoja e popullatës për të përmirësuar cilësinë e jetesës së tyre ka ndikuar që njerëzit në mënyrë të vullnetshme apo të pavullnetshme të lëvizin nga një vendbanim në një tjetër brenda kufijve të një shteti apo jashtë kufijve të tij. Sipas një definicioni zyrtar nga faqja e qeverisë së Kosovës, me “emigrim kombëtar” kuptojmë “lëvizjen nga një vendbanim në një ndonjë vendbanim tjetër por, brenda kufijve kombëtar”.<sup>1</sup> Hulumtimi “Emigrimi Kombëtar i të Rinjëve në Komunën e Gjakovës” përveç se mat perceptimin e të rinjëve të Gjakovës për ekonominë, shëndetësinë, sigurinë, arsimin dhe kulturën në komunën e Gjakovës, mat edhe dëshirën e tyre për një largim të mundshëm nga kjo komunë.

Hulumtimi nis fillimisht me rishikimin e literaturës duke bërë një shpjegim të përgjithshëm historik e deri në ditët më të reja për ekonominë, kulturën, shëndetësinë, arsimin dhe sigurinë në komunën e Gjakovës. Më tej, pasiqë është shpjeguar rënia e përgjithshme e qytetit të Gjakovës është bërë një krahasim i rënies së komunës së Gjakovës me disa qytete tjera

---

<sup>1</sup> A. (2014). Migrimi Kosovar (p. 11, Rep.). Pristina, Kosovo: Agjencia e Statistikave të Kosovës.

në Evropë dhe në SHBA. Ky krahasim dëshmon se si cilët faktorë mund të shpjegojnë rënien në komuna të caktuara.

Pjesa e metodologjisë tregon rrugën e ndjekur nga hulumtuesi për realizimin e këtij hulumtimi. Hulumtimi është realizuar me 250 të rinjë nga komuna e Gjakovës dhe realizues të këtij hulumtimi kanë qenë studentët e Kolegjit Universum.

Në pjesën e të gjeturave janë shpjeguar përgjigjet e të anketuarve mbi përceptimin e tyre për ekonominë, shëndetësinë, arsimin, sigurinë dhe kulturën. Po ashtu, është matur opinion i të rinjëve të komunës së Gjakovës mbi dëshirën e tyre për ta lënë ose jo vendbanimin e tyre, qyteti i preferuar si destinacion për largim nga komuna e Gjakovës dhe arsyen kryesore të të rinjëve për emigrim nga komuna e Gjakovës.

Konkluzioni në fund ofron një përmbledhje përfundimtare lidhur me temën duke ofruar edhe një mesazh përmbyllës lidhur me subjektin e kërkimit tonë.

## **Rishikimi i Literaturës**

Qyteti i Gjakovës shtrihet në pjesën jug-perëndimore të Gjakovës. Sipas të dhënave të censusit të fundit, Gjakova ka një popullsi prej 150.000 banorësh.<sup>2</sup> Para se ta shqyrtojmë rastin e emigrimit kombëtar në komunën e Gjakovës duke bërë një lloj krahasimi me vendet tjera të cilat janë ballafaquar me rënie të përgjithshme, do të diskutojmë për indikatorët e vlerësuar si kyç për mirëfunksionimin e një qyteti të caktuar. Në këtë hulumtim si indikatorë kyç janë vlerësuar: ekonomia, shëndetësia, siguria, arsimi dhe kultura. Para se të diskutojmë për rastet e ngjashme me Gjakovën sa i përket rënies që kanë pësuar, do të shqyrtojmë indikatorët e lartpërmendur në kontekstin e komunës së Gjakovës.

Sa i përket ekonomisë, Gjakova është i njohur si qytet për traditën e punës në industri dhe bujqësi. Po ashtu, ky qytet është shquar edhe për punën në zejтари, tregti dhe shërbime. Faktor i rëndësishëm në ekonominë e Gjakovës ka qenë edhe popullata e re. Gjakova historikisht është shquar si një vend i fokusuar në zejтари, tregti, bujqësi, blegtori por edhe në disa aspekte të

---

<sup>2</sup> Harxhi-Begolli, B. (2013). Përkrahja për Promovimin e Diversitetit Kulturor Komponenta e Zhvillimit Ekonomik Lokal (p. 5, Rep.). Prishtinë, Kosovo: European Union.

ndryshme të manufakturës.<sup>3</sup> Falë lidhjeve me Shkodrën, Dubrovnikun, Venedikun, Bullgarinë e disa vende tjera, ekonomia e Gjakovës shënoi përparim të madh në shekullin XVIII. Në këtë periudhë shquhej edhe bashkimi i zejtarëve të komunës së Gjakovës në bashkimet e quajtura “esnafe” të cilat ishin përgjegjëse për iniciativa të ndryshme me ndikim pozitiv në komunën e Gjakovës. Gjakova në pjesën e dytë të shekullit XX e gati pothuajse deri në fund të shekullit XX është karakterizuar si një vend mjaft industrial dhe me ekonomi të zhvilluar e prosperitet në përgjithësi.<sup>4</sup>

Prej vitit 1999, ekonomia e Gjakovës është përballur me ndërrime të cilat kanë qenë karakteristike për shoqëritë në tranzicion. Struktura e tanishme ekonomike e Gjakovës mbështetet në dy shtylla: në biznesin privat dhe atë shoqëror i cili është në privatizimin e sipër.<sup>5</sup> Biznesi privat është në rritje dhe pritet të jetë bartësi kryesor i zhvillimit ekonomik të vendit.

Komuna e Gjakovës po ashtu ka një kulturë të zhvilluar. E lokalizuar në pjesën jug-perëndimore të Kosovës, Gjakova ka qenë një pikë pushuese për udhëtarët që vinin prej Prizrenit në Pejë. Disa nga pikat e rëndësishme apo definuese të komunës së Gjakovës janë Kodra e Çabratit, lumenjtë Drini i Bardhë, Krena, Ereniku etj. Komuna e Gjakovës ka 85 fshatra dhe ka vende të ndryshme që përfshijnë: kulla të ndryshme, shtëpi tradicionale, xhami, kisha, medrese, mejtepe, mullinjë të ndryshëm etj. Ndonëse lufta e vitit 1999 solli shumë shkatërrime të këtyre objekteve, komuna e Gjakovës ka arritur të ruajë dhe rikthejë pjesën më të madhe të këtyre objekteve të trashëgimisë kulturore. Gjithsesi, këto përpjekje janë në vijim e sipër. Duhet të theksohet që Gjakova ka 148 monumente të trashëgimisë kulturore që janë konsideruar për t’u mbrojtur ndërsa janë edhe 109 monumente të kulturës arkitektonike të vendit.<sup>6</sup>

---

<sup>3</sup> K. (2018). *Ekonomia* (Rep.). Retrieved June 8, 2018, from Republika e Kosovës website: <https://kk-arkiva.rks-gov.net/gjakove/City-guide/GjakovaTriZonaKomun.aspx>

<sup>4</sup> G. (2018). *EKONOMIA* (Rep.). Retrieved June 9, 2018, from Gjakova Portal website: <http://gjakovaportal.com/en/qyteti/ArtMID/517/ArticleID/3092327/Ekonomia>

<sup>5</sup> Ibid.

<sup>6</sup> Saraçini, K. (2017, March 23). Gjakova, qyteti i pasurive të mëdha arekologjike dhe arkitekturore. Retrieved June 9, 2018, from <http://arkiva.ata.gov.al:8080/gjakova-qyteti-i-pasurive-te-medha-arekologjike-dhe-arkitekturore/>



Gjakova ka një traditë sa i përket arsimit e cila fillon që nga vetë ekzistenca e këtij qyteti. Dallohet në fund të shekulli XVI biblioteka e Hadim agës. Më tej pjesëtarët e familjes Kurtpasha ndihmuan në zhvillimin e arsimit në komunën e Gjakovës duke ndërtuar xhami, mejtepe dhe medrese. Sipas të dhënave të ndryshme, shkollat në gjuhën shqipe në komunën e Gjakovës janë hapur para vitit 1840. Më tej, në kuadër të reformave të Tanzimatit u hapën shkolla të ndryshme në gjuhën turke. Megjithatë, përpjekjet më të intensifikuara për zhvillimin e arsimit në gjuhën shqipe i hasim në fillim të shekullit XX.

Në fillim të shekullit XX kishte kurse të ndryshme të mësimin të gjuhës shqipe. Veprimtari i njohur Bajram Curri që në vitin 1911 bëri përpjekje për hapjen e shkollave në gjuhën shqipe. Pas luftës së parë botërore krijohen kushte më të përshtatshme për shkollat shqipe në komunën e Gjakovës. Një lloj rilindje kulturore për qytetin e Gjakovës shënoi fillimi i shkollës normale (shkollë e mesme dy vjeçare) në vitin 1946 e cila ishte në fakt e para e atij lloji në Kosovë. Në vitin 1953 hapet edhe gjimnazi “Hajdar Dushi”. Në historinë moderne, prej vitit 2013, Gjakova është një qytet universitar në të cilin operojnë edhe shumë shkolla të ndryshme publike dhe private në të gjitha nivelet e edukimit.<sup>7</sup>

Sistemi i shëndetësisë në Komunën e Gjakovës ka një shtrirje mjaft të gjerë e cila mbulon tërë territorin e komunës. Komuna e Gjakovës përveç Qendrës Kryesore për Mjekësi Familjare (QKMF) ka edhe tetë qendra të mjekësisë familjare dhe 15 punkte apo ambulanca. Në pjesën e brendshme të qytetit të Gjakovës operon edhe spitali “Isa Grezda”. Ky spital nuk menaxhohet nga komuna e Gjakovës por nga Ministria e Shëndetësisë. Përveç institucioneve të lartpërmendura, në Gjakovë funksionon edhe qendra për shëndet mental dhe shtëpia mbrojtëse për rastet psikiatrike. Në Gjakovë ekziston edhe dega e Institutit Kombëtar për Shëndet Publik që përkujdeset për situatën higjienike-epidemiologjike në vend. Qendrat e mjekësisë familjare janë të shpërndara në pjesët urbane dhe rurale të qytetit. Sipas të dhënave të vitit 2013, në sektorin e shëndetësisë në Gjakovë punonin 304 persona.<sup>8</sup>

---

<sup>7</sup> G. (2014). ARSIMI I GJAKOVËS. Retrieved June 8, 2014, from <http://gjakovaportal.com/al/kultura/ArtMID/542/ArticleID/1202882/Arsimi-i-Gjakov235s>

<sup>8</sup> I. (2013). Letërnjoftimi i Komunës së Gjakovës 2013 (p. 18, Rep.). Pristina, Kosovo: GAP Institute.

Sa i përket sigurisë në komunën e Gjakovës, zona e përgjegjësisë së Drejtorisë Rajonale në Gjakovë është bazuar në ndarjen që ka gjyqësori dhe kjo zonë përfshin komunën e Gjakovës, të Rahovecit dhe të Malishevës. Në këtë zonë që përfshin Gjakovën kemi prokurori, gjykata, kuvende komunale, ndërtesa të policisë dhe shumë objekte të ndryshme me karakter ekonomik, kulturor dhe historik që i japin mjaft rëndësi sigurisë për këtë hapësirë. Komuna e Gjakovës ka një hapësirë prej 591 km dhe përfshin 91 vendbanime. Sipas policisë së Gjakovës, objekte me rëndësi të veçantë në këtë komunë janë: institucionet gjyqësore, stacioni policor në Gjakovë, policia kufitare, etj. Në përgjithësi, mbulimi i sigurisë në këtë zonë është i ndarë në 4 sektorë të cilët janë: tre sektorë të zonave rurale dhe një sektor i qytetit i cili ndahet në katër pjesë më të vogla.<sup>9</sup>

Gjakova në historinë moderne- pra prej pjesës së dytë të shekulli XX e deri në fund të shekullit XX shquhet si vend i zhvilluar industrialisht. Ekonomia e Gjakovës në këtë periudhë kishte lulëzuar duke ndikuar shumë pozitivisht në mirëqenien e qytetarëve të kësaj komune. Megjithatë, lufta e vitit 1999 ishte shkaktare e një rënie të dukshme të ekonomisë së komunës së Gjakovës. Kjo rënie u shqua me mbylljen e shumë fabrikave/objekteve industriale në këtë komunë dhe si rrjedhojë edhe me shtim të theksuar të papunësisë në vend. Pasojat e kësaj rënieje ekonomike kanë qenë të dukshme që prej periudhës së pas-luftës e deri më tani në ditët më të reja. Në këtë kontekst, për nevoja të hulumtimit, është mirë që të diskutojmë edhe për raste të ngjashme me komunën e Gjakovës të cilat janë përballur me një rënie të përgjithshme. Këto raste na shërbejnë si një lloj krahasimi me situatën në komunën e Gjakovës.

Paralelizëm me situatën e komunës së Gjakovës fillimisht mund të bëjmë me disa qytete/shtete në Evropë dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në Evropë si shembuj të kësaj dukurie të rënies ekonomike dhe popullsisë kemi qytetet Bochum nga Gjermania dhe qytetin Belfast nga Uells. Në Amerikë si shembull i kësaj dukurie është marrë Detroit. Fillimisht, si shkak i rëndësishëm i rënies së këtyre qyteteve ka qenë prezenca e industrisë së rëndë. Detroiti ishte njëri ndër qytetet me zhvillimin dhe rritjen më të shpejtë në SHBA si rezultat i industrisë automotiv. Bochum ishte i njohur si qendër e çelikut dhe qymyrgurit dhe më pas edhe si vend

<sup>9</sup> DREJTORIA RAJONALE E POLICISË-GJAKOVË (Rep.). (2018). Retrieved June 8, 2018, from Policia e Kosovës website: <http://www.kosovopolice.com/sq/drp-gjakove>

ku kishin ndërtesat e tyre firmat si Nokia dhe Opel. Belfasti ndërkaq ishte qendër e ndërtimit të anijeve dhe inxhinierisë.<sup>10</sup>

Si rezultat i pagave të mira për punë të cilat kërkonin pak aftësi për punëtorë, këto vende përjetuan edhe rritje të madhe të popullsisë. Megjithatë, kjo bëri që edhe njerëzit të mos merrnin edukimin e duhur që të nisnin vetë bizneset e tyre. Si rezultat i rënies së industrive kyçe për këto vende si pasojë e globalizimit ekonomik në botë, këto vende e patën të vështirë të lëviznin nga ekonomia e rëndë në një ekonomi të dijes. Në këto rrethana, këto vende përjetuan një rënie të ngadalshme por edhe me pasoja afat-gjate. Pasi që këto vende nuk arritën të kishin të njëjtin rol industrial, nuk arritën që të përjetonin rigjenerim urban dhe rritje të industrive kreative. Duke patur parasysh rrethanat e tilla, të rinjtë e talentuar të këtyre vendeve filluan të largoheshin në vende tjera për të kërkuar mundësi më të mira ekonomike duke i lënë Detroitin, Bochumin dhe Belfastin me një fuqi punëtoresh jo të kualifikuar dhe me mungesë të mundësive për punë. Kjo situatë e ka bërë edhe më të vështirë kalimin në industri më produktive.<sup>11</sup>

Një artikull i vitit 2017 nga CBS News identifikon edhe rënien e popullsisë së 12 qyteteve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Duke bërë krahasim me qytetin e Gjakovës, edhe këto qytete në të kaluarën kanë qenë ish-superfuqi ekonomike të cilat kanë pësuar rënie si pasojë e rënies së fuqisë së industrisë prodhuese në SHBA. Ndonëse Gjakova nuk është një superfuqi në asnjë aspekt, siç edhe u theksua më herët, ka qenë një vend me një ekonomi solide e cila tashmë ka pësuar rënie të dukshme dhe kjo rënie më pas është përcjellë edhe me një rënie të përgjithshme të qytetit në çdo aspekt.<sup>12</sup> Rënia e popullsisë në këto qytete në SHBA ka zvogëluar edhe numrin e taksapaguesve dhe si rezultat edhe mundësitë për një rimëkëmbje ekonomike.

Komuna e Gjakovës ndonëse me një të kaluar të bujshme në shumë dimensionë ende përballet me një rënie të theksuar ekonomike që prej periudhës së pasluftës e më tej. Siç edhe u pa në shembujt e lartpërmendur, rënia ekonomike prodhon edhe shumë pasoja tjera sociale për

---

<sup>10</sup> Gordon, L. (2013, September 16). The Decline of Great Industrial Cities (Rep.). Retrieved June 8, 2018, from Euro Monitor website: <https://blog.euromonitor.com/the-decline-of-great-industrial-cities/>

<sup>11</sup> Ibid.

<sup>12</sup> Picchi, A. (2017, June 22). 12 Major American Cities that are Shrinking (Rep.). Retrieved June/July, 2018, from CBS Interactive Inc website: <https://www.cbsnews.com/media/12-major-american-cities-that-are-shrinking/>

popullsinë e këtyre vendbanimeve e cila më tej rrezikon edhe rënien e popullsisë së këtyre vendeve duke vështirësuar edhe më shumë rimëkëmbjen ekonomike të këtyre vendeve.

## **Metodologjia**

Hulumtimi “Emigrimi Kombëtar i të Rinjëve në Komunën e Gjakovës” është kryer me një mostër prej 250 të rinjëve nga mosha 18 deri 35 vjeç nga të dy gjinitë dhe nga prejardhjet e ndryshme socio-ekonomike. Për çështje thjeshtësie, hulumtimi është kryer përmes mostrimit aksidental. Ky lloj mostrimi është i përshtatshëm në kushtet e Kosovës duke patur parasysh edhe që Kosova ka një popullatë të theksuar të të rinjëve. Hulumtimi është kryer në pjesën urbane dhe rurale të Qytetit të Gjakovës. Hulumtimi është kryer nga studentët e “Kolegjit Universum” të vitit të parë në kuadër të lëndës “Metodat Hulumtuese”. Mbledhja e të dhënave ka zgjatur rreth dy javë dhe është realizuar përmes një pyetësoari.

## **Të Gjeturat**

Hulumtimi mbi emigrimin kombëtar të rinjëve të Komunës së Gjakovës kishte për qëllim matjen e perceptimit e të rinjëve të Komunës së Gjakovës për komunën e tyre bazuar në pesë indikatorë kyç që janë ekonomia, shëndetësia, arsimi, siguria dhe kultura dhe njëkohësisht mat tendencën e të rinjëve të kësaj komune që të largohen drejt njëres nga gjashtë komunat tjera të Kosovës. Komunitat të cilat janë përfshirë në këtë hulumtim si opsione të mundshme për emigrim kombëtar nga qytetarët e komunës së Gjakovës janë: Prishtina, Prizreni, Ferizaji, Gjilani, Peja dhe Mitrovica.

Fillimisht struktura e të rinjëve pjesëmarrës që varionin nga moshta 18 deri 35 vjeç anon tek grupmosha 18-23 vjeç që paraqet 52.2% të pjesëmarrësve në total ndërsa grupmoshat prej 24-29 dhe 30-35 na paraqiten me përqindje prej 30.9%, përkatësisht 16.9%. Në anën tjetër, sa i përket gjinisë të të anketuarve, mund të themi se ekziston një pjesëmarrje pothuajse e barabartë në hulumtim mes meshkujve dhe femrave. Në hulumtimin e kryer 51.2% e të anketuarve kanë qenë meshkuj ndërsa 48.8% nga totali i përkasin gjinisë mashkullore.


Hulumtimi, siç është theksuar më herët ka përfshirë pjesën urbane dhe rurale të Komunës së Gjakovës. Megjithatë, ndoshta edhe si rezultat i mënyrës së mostrimit, vërejmë një pjesëmarrje më të theksuar të të anketuarve nga zona urbane e qytetit të cilët marrin pjesë me 66.1% nga totali i përgjithshëm i të anketuarve. Në anën tjetër, të anketuarit nga pjesa rurale e Komunës së Gjakovës përbjënë 33.9% të të anketuarve.

Hulumtimi po ashtu mat edhe ndarjen e të anketuarve sa i përket të ardhurave të tyre familjare. Të ardhurat e paraqitura në këtë hulumtim ndahen në këto grupe: 0-200, 250-450, 500-700, 750-950 dhe mbi 950 euro. Vërejmë që pjesa më e madhe të anketuarve bijnë tek kategoria 250-450 euro ose shprehur në përqindje 37.2%. Kategoria e dytë sa i përket pjesëmarrjes është 500-700 euro, kategori në të cilën bëjnë pjesë 29.2% e të anketuarve. Në kategorinë prej 750-950 euro bëjnë pjesë 14.4% e të anketuarve. Kategoria e parafundit për nga prezenca e të anketuarve është prej 0-200 euro që është 10.4% e totalit. Numri më i vogël i të anketuarve bënë pjesë në kategorinë mbi 950 euro e që shprehur në përqindje është 8.8% nga totali.

Sa i përket shkollimit të të anketuarve, më shumë se gjysma e tyre ose 51.2% janë me shkollim universitar. Më tej, 26.4% e të anketuarve u shprehën që kanë të përfunduar shkollimin e mesëm. Nga të anketuarit, 14.4% u shprehën që kanë të përfunduara studimet e nivelit Master. Veteëm 8% e të anketuarve u shprehën që kishin të përfunduara studimet doktorale, shkollimin fillor apo edhe që ishin pa shkollim fare.


Qytetarët e Komunës së Gjakovës po ashtu janë anketuar për përceptimin e tyre mbi disa indikatorë të ndryshëm si ekonomia, shëndetësia, sigurimi, arsimit dhe kultura. Atyre u është kërkuar të japin një vlerësim nga numri 1 deri në 10 mbi këta indikatorë ku numri 1 nënkupton që ai indikator vlerësohet si shumë keq ndërsa numri 10 nënkupton që indikatorin i caktuar vlerësohet si shkëlqyeshëm. Në pyetjen mbi përceptimin e të rinjve të komunës së Gjakovës për ekonominë e vendi, 39 apo 16% e të anketuarve e vlerësuan me 4 ndërsa 33 apo 13% e të anketuarve e vlerësuan me 3 apo 5. Më tej, numri më i vogël i të anketuarve janë përgjigjeur për opsionet 1 dhe 8 e që shprehur në përqindje janë 5.3% e të anketuarve përkatësisht 5.4% e të anketuarve total. Më poshtë gjendet grafi i cili përshkruan se si janë përgjigjur të anketuarit lidhur me përceptimin e tyre mbi ekonominë e Komunës së Gjakovës.

## Përceptimi i të Rinjëve të Komunës së Gjakovës për Ekonominë në Një Shkallë prej 1-10




Të anketuarit në këtë hulumtim u pyetën edhe për përceptimin e tyre mbi shëndetësinë në Komunën e Gjakovës. Numri më i madh i të anketuarve apo 40 e që shprehur në përqindje përbëjnë 16% të anketuarve vlerësuan shëndetësinë në Gjakovë me vlerën 5. Dy vlerat tjera më të përhapura kanë janë 36 (14.4%) që vlerësuan shëndetësinë me vlerën 4 ndërsa 35 nga të anketuarit vlerësuan ekonominë me 6 pikë. Vlera më së paku të zgjedhura nga të anketuarit për shëndetësinë ishin 1, 2 dhe 9. Vetëm 9 të anketuarve vlerësuan shëndetësinë në Komunën e Gjakovës me notën 1 e që shprehur në përqindje është 3.6% nga totali. Vlerat 2 dhe 9 për shëndetësinë i zgjodhën 15 të anketuar për secilën e që në përqindje shprehet si 6% nga totali. Grafi në vijim tregon shpërndarjen e vlerave nga përceptimi i të anketuarve mbi shëndetësinë në Komunën e Gjakovës.

## Përceptimi i të Rinjëve të Komunës së Gjakovës për Shëndetësinë në Një Shkallë prej 1-10



Pyetja e radhës në hulumtim trajton perceptimin e të rinjëve të komunës së Gjakovës për gjendjen e edukimit në këtë komunë. Nga të anketuarit, pjesa më e madhe ose 40 nga anketuarit e që shprehur në përqindje janë 16.1% , vlerësojnë edukimin me notën 5. Numri i dytë më i madh i të anketuarve apo 37 nga totali e vlerësojnë edukimin me vlerën 8.


Nga të anketuarit, 21 veta e vlerësojnë edukimin në Komunën e Gjakovës me 3 dhe 4. Vlerat të cilat ishin më së paku të përzgjedhura nga të anketuarit janë 1 dhe 2. Me vlerën 1 edukimin në Komunën e Gjakovës e vlerësuan 7 nga të anketuarit ose 2.8% ndërsa vetëm gjashtë pjesëmarrës të hulumtimit vlerësuan edukimin me vlerën 2 që përbëjnë vetëm 2.4% të totalit të të anketuarve. Grafiku në vijim tregon edhe mënyrën se si janë të shpërndara vlerat lidhur me perceptimin e të rinjëve të Komunës së Gjakovës për edukimin.



Aspekti i tjetër i shqyrtuar në këtë hulumtim ishte perceptimi i të rinjëve të Komunës së Gjakovës për nivelin e sigurisë. Opinioni i qytetarëve lidhur me sigurinë në qytetin e Gjakovës varion në masë të madhe. Nga numri i përgjithshëm, 30 të anketuar e vlerësojnë ekonominë me vlerën 1. Shprehur në përqindje kjo nënkupton 12% nga totali. Më tej, 27 nga të anketuarit ose 10.8% nga totali e vlerësuan sigurinë në komunën e Gjakovës me vlerat 7 dhe 8.

Sa i përket pyetjes mbi sigurinë në komunën e Gjakovës, të rinjtë e kësaj komune në masën më të vogël i zgjedhën vlerat 2 dhe 6. Nga totali i të anketuarve, 19 ose 7.6 e vlerësuan sigurinë në Gjakovë me 2 kurse 21 apo 8.4% vlerësuan sigurinë në Gjakovë me 6. Të dhënat mbi perceptimin e sigurisë në komunën e Gjakovës nga të rinjtë janë paraqitur në grafën e mposhtëm.


### Përceptimi i të Rinjëve të Komunës së Gjakovës për Sigurinë në Një Shkallë prej 1-10



Indikatori tjetër i cili është marrë për shqyrtim në këtë hulumtim është kultura. Të rinjtë e Gjakovës janë pyetur për përceptimin e tyre mbi kulturën në shkallën e njejtë prej 1 deri 10. Nga të anketuarit, një numër i konsiderueshëm në raport me totalin e të anketuarve ose 47 kanë vlerësuar kulturën në komunën e Gjakovës me notën 10. Kjo, shprehur në përqindje është 18.9% e totalit. Vlera e dytë më e zgjedhur nga të anketuarit ka qenë 9. Nga totali i të anketuarve, 38 kanë zgjedhur këtë vlerë dhe kjo përbën 15.3 % të totalit të anketuarve. Vlen të theksohet se 27 nga pjesëmarrësit e hulumtimit e kanë vlerësuar kulturën me 6 dhe 7 e që shprehur në përqindje janë 10.8% nga totali.


Vlerat më të vogla si 1 dhe 2 kanë qenë edhe vlerat më së paku të zgjedhura nga qytetarët. Kulturën me 1 e kanë vlerësuar 10 apo 4% e të anketuarve ndërsa me 2 e kanë vlerësuar 9 apo 3.6% e qytetarëve të anketuar. Grafi në vijim shpreh se si janë shpërndarë përgjigjet e të rinjëve të komunës së Gjakovës lidhur me përceptimin e tyre për kulturën.

### Përceptimi i të Rinjëve të Komunës së Gjakovës për Kulturën në Një Shkallë prej 1-10





Pas vlerësimit të qytetarëve të rinj të komunës së Gjakovës mbi indikatorët kyç të lartpërmendur, ata u pyetën mbi dëshirën e tyre për t'u larguar ose jo nga qyteti i Gjakovës. Nga 248 personat të cilët u përgjigjën në këtë pyetje, 139 persona thanë që do të donin të largoheshin nga Gjakova. Shprehur në përqindje kjo është 56%. Në anën tjetër 109 persona ose 46% thanë që do të donin të vazhdonin të jetonin në Gjakovë. Diagrami në vijim tregon ndarjen e opinionit të të anketuarve mbi dëshirën e tyre për largim ose jo nga qyteti i Gjakovës.




Pas pyetjes mbi preferencën e të rinjëve të komunës së Gjakovës për largim apo jo nga ky qytet, të rinjtë u pyetën edhe për qytetin e preferuar në të cilin ato do të donin të emigronin. Opsionet e paraqitura si destinacione të mundshme për të rinjtë e komunës së Gjakovës ishin këto: Prishtina, Prizreni, Peja, Ferizaji, Mitrovica dhe Gjlani. Pjesa dërrmuese apo 97 nga ata të cilët u përgjigjën që do të largoheshin nga Gjakova, destinacionin e tyre të preferuar e patën Prishtinën. Shprehur në përqindje kjo është 66% e totalit. Më tej, 26 apo 18% e të anketuarve zgjodhën Prizrenin si destinacion të preferuar. Nga të anketuarit, 12 apo 8% u shprehën që Peja ishte qyteti ku ata do donin të shkonin. Tre qytetet më pak të preferuara për emigrim nga të rinjtë e komunës së Gjakovës ishin Gjlani, Ferizaji dhe në fund Mitrovica. Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, vetëm 8% zgjodhën njërin nga këta qytete. Diagrami në vijim shpreh preferencën e të rinjëve të Gjakovës mbi qytetin ku ata dëshirojnë të emigrojnë.



Të rinjtë e komunës së Gjakovës po ashtu u pyetën edhe për arsyen e tyre kryesore për largim nga ky vendbanim. Opsionet të cilat u ofruan si arsye të mundshme për largimin nga komuna e Gjakovës ishin: më shumë mundësi punësimi, përvojë e re kulturore, ambienti është më miqësor, kam miq ose familjarë atje dhe shërbimet lokale janë më të mira.

Nga totali i atyre që dhanë arsye për largimin e mundshëm nga komuna e Gjakovës, 76 apo 51% thanë që arsyeja kryesore e tyre për largim ishte më shumë mundësi punësimi. Si arsye në vendin e dytë radhitet dëshira për një përvojë të re kulturore. Nga totali, 21 apo 14% e zgjedhën këtë opsion. Më tej, 19 apo 13% e të anketuarve u përgjigjën që nuk kishin ndonjë arsye të veçantë për largimin e tyre të mundshëm nga qyteti i Gjakovës. Opsioni i radhës i preferuar ishte “kam miq apo familjarë atje”. Nga numri total i të anketuarve, 17 apo 11% e zgjedhën këtë opsion. Opsioni më së paku i preferuar nga të rinjtë e komunës së Gjakovës kishte të bënte me perceptimin se shërbimet lokale janë më të mira në qytetin ku ata pretendojnë të shkojnë. Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, vetëm 6 apo 4% zgjedhën këtë opsion. Diagrami në vijim shpreh shpërndarjen e opinionëve të të anketuarve mbi këtë pyetje.



## Konkluzioni

Hulumtimi mbi emigrimin kombëtar të të rinjëve në komunën e Gjakovës trajton çështjen e emigrimit në kontekstin e komunës së Gjakovës duke matur dëshirën e të rinjëve të këtij qyteti për t'u larguar apo jo nga komuna e Gjakovës dhe perceptimin e tyre lidhur me indikatorët më të rëndësishëm për mirëqenien e qytetarëve si ekonomia, shëndetësia, siguria, kultura dhe arsimit.

Në fillim të këtij hulumtimi tek rishikimi i literaturës është bërë një shpjegim i përgjithshëm lidhur me ekonominë, shëndetësinë, kulturën, sigurinë dhe arsimin në kontekstin e qytetit të Gjakovës. Është bërë shpjegimi i këtyre indikatorëve duke treguar se si këta indikatorë kanë qenë në të kaluarën dhe si kanë evoluar ata deri në ditët e sotme.

Pjesa e metodologjisë ka treguar se si është ndërtuar ky hulumtim duke shpjeguar që ky hulumtim është realizur nga studentët e Kolegjit Universum dhe që mostra në këtë rast kanë qenë të rinjtë e pjesës urbane dhe rurale të Gjakovës. Mosha e të anketuarve ka qenë prej 18 deri 35 vjeç.

Më tej, pasi është shpjeguar rënia ekonomike dhe e përgjithshme e komunës së Gjakovës, këtij shpjegimi i është bashkangjitur edhe shpjegimi i rasteve të ngjashme të qyteteve botërore si Detroit në SHBA dhe Bochum e Belfast të cilët po ashtu kanë pësuar rënie ekonomike dhe si rezultat edhe humbje të popullsisë.

Pjesa e të gjeturave ka treguar rezultatet nga opinionet e të anketuarve në këtë hulumtim lidhur me perceptimin e tyre mbi gjendjen e ekonomisë, shëndetësisë, sigurisë, kulturës dhe arsimit në komunën e Gjakovës. Po ashtu, në këtë pjesë janë paraqitur opinionet e qytetarëve mbi dëshirën për t'u larguar apo jo nga qyteti i Gjakovës, destinacionin e tyre të preferuar për largim në Kosovë dhe arsyen kryesore të tyre për largim nga komuna e Gjakovës.

Tema e emigrimit kombëtar në Kosovën e pasluftës është bërë mjaft serioze duke patur parasysh rënien e përgjithshme ekonomike të vendit. Kjo rënie ekonomike ka prekur edhe qytetin e Gjakovës e cila më pas ngrit edhe pikëyetjen mbi emigrimin kombëtar të mundshëm të qytetarëve të këtij vendi. Në këtë mënyrë, fokusi i hulumtimit ka qenë që të kuptohet reagimi ose perceptimi i të rinjëve të komunës së Gjakovës në këto rrethana dhe opinionin e tyre për një braktisje të mundshme të vendlindjes së tyre. Emigrimi kombëtar është një çështje e cila meriton shumë vëmendje dhe trajtim nga të gjithë e veçanërisht nga institucionet e Republikës së Kosovës.

## Referencat

- A. (2014). Migrimi Kosovar (p. 11, Rep.). Pristina, Kosovo: Agjencia e Statistikave të Kosovës.
- DREJTORIA RAJONALE E POLICISË-GJAKOVË (Rep.). (2018). Retrieved June 8, 2018, from Policia e Kosovës website: <http://www.kosovopolice.com/sq/drp-gjakove>
- G. (2014). ARSIMI I GJAKOVËS. Retrieved June 8, 2014, from <http://gjakovaportal.com/al/kultura/ArtMID/542/ArticleID/1202882/Arsimi-i-Gjakov235s>
- G. (2018). EKONOMIA (Rep.). Retrieved June 9, 2018, from Gjakova Portal website: <http://gjakovaportal.com/en/qyteti/ArtMID/517/ArticleID/3092327/Ekonomia>
- Gordon, L. (2013, September 16). The Decline of Great Industrial Cities (Rep.). Retrieved June 8, 2018, from Euro Monitor website: <https://blog.euromonitor.com/the-decline-of-great-industrial-cities/>
- Harxhi-Begolli, B. (2013). Përkrahja për Promovimin e Diversitetit Kulturor Komponenta e Zhvillimit Ekonomik Lokal (p. 5, Rep.). Prishtinë, Kosovo: European Union.
- I. (2013). Letërnjoftimi i Komunës së Gjakovës 2013 (p. 18, Rep.). Pristina, Kosovo: GAP Institute.
- K. (2018). Ekonomia (Rep.). Retrieved June 8, 2018, from Republika e Kosovës website: <https://kk-arkiva.rks-gov.net/gjakove/City-guide/GjakovaTriZonaKomun.aspx>
- Picchi, A. (2017, June 22). 12 Major American Cities that are Shrinking (Rep.). Retrieved June/July, 2018, from CBS Interactive Inc website: <https://www.cbsnews.com/media/12-major-american-cities-that-are-shrinking/>
- Saraçini, K. (2017, March 23). Gjakova, qyteti i pasurive të mëdha arekologjike dhe arkitekture. Retrieved June 9, 2018, from <http://arkiva.ata.gov.al:8080/gjakova-qyteti-i-pasurive-te-medha-arekologjike-dhe-arkitekture/>